



Stadt Bern



Drejtoria për Arsim  
Mirëqenien Sociale dhe Sport

Shërbimi Social

# Fletë informuese lidhur me mirëqenien sociale



## Informacion i përgjithshëm

---

### **Komuna e juaj ndërmerr masa preventive**

Ligji për Mirëqenien Sociale të kantonit të Bernës vendos, që komunat t'u garantojnë banoreve e banorëve të tyre siguri sociale. Komunat e kanë për detyrë që të mënjanojnë shkaqet e problemeve të rënda sociale si dhe të parandalojnë kanosjen nga varfëria. Në qytetin e Bernës, Drejtoria për Arsim, Mirëqenie Sociale dhe Sport (BSS) është përgjegjëse për të gjitha çështjet në fushën e shërbimeve sociale.

### **Shërbimi Social: Këshillim dhe ndihmë – falas dhe kompetent**

Nëse ju dhe anëtarët tuaj të familjes bini në një gjendje të rëndë financiare apo sociale, keni të drejtë të shfrytëzoni ndihmën e Shërbimit Social. Si parakusht për këtë është që të jeni duke jetuar në qytetin e Bernës. Ndhima financiare e Shërbimit Social do të rezultojë, nëse nuk ka në dispozicion oferta të tjera ndihmëse.

### **Si ndihmon Shërbimi Social?**

Ndhima (asistenca) sociale duhet t'i përgjigjet gjendjes tuaj personale, sociale dhe financiare. Synimi i shërbimeve sociale është që t'ju tregohen shtigjet për në pavarësimin tuaj personal dhe financiar dhe t'ju përkrah në këtë aspekt. Përkrahja financiare organizohet sipas Konferencës Zvicerane për Mirëqenie Sociale (SKOS)

## Cilat shërbime ofron Shërbimi Social?

---

### **Informacion dhe ndërmjetësim**

Punëtorët/et social/e ju ndihmojnë të kontaktet me autoritetet e tjera si p.sh. Arkat e Kompensimit etj. Pastaj ndërmjetësojnë kontakte me institucione të tjera si këshillimoret, komunat e kishës, mjekët etj.

### **Këshillimi dhe biseda**

Punëtorët/et social/e ju këshillojnë në raste të vështirësive personale, financiare dhe në përgjithësi atyre ligjore. Kjo bëhet edhe nëse nuk është e organizuar ndihma financiare.

### **Përkrahja financiare**

Nëse janë shterur të gjitha burimet e tjera financiare (sigurimet, punëdhënësi, arka e papunësisë, pasuria) ju keni të drejtë të kërkoni ndihmë financiare nga Shërbimi Social. Llogaritja e ndihmës financiare bëhet ashtu që ajo të mund të mbulojë koston tuaj të tanishme jetësore. Në këtë llogaritje merret parasysh numri i personave që jetojnë në të njëjtën shtëpi. Që të llogaritet ndihma financiare, duhet të bëhet një buxhet përkrahës, në të cilin do të krahasohen të gjitha të ardhurat me shpenzimet tuaja të detyrueshme. Parimisht, Shërbimi Social nuk i merr përsipër borxhet ekzistuese.

Nëse prindërit apo fëmijët tuaj jetojnë në kushte të mira financiare, mund të pretendohet një përkrahje nga të afërmit . "Detyrimi për përkrahje nga të afërmit" sipas nenit 328 të Kodit Civil do të verifikohet gjithsesi. Sipas ligjit për Mirëqenie Sociale në rrethana të caktuara ndihma sociale e shfrytëzuar duhet detyrimisht të kthehet prapa. Kthimi i ndihmës so-

cialë është i detyrueshëm nëse përfitimet nga sigurimet paguhen më vonë, nëse me fajin tuaj e keni shkaktuar gjendjen e rëndë financiare, nëse fitoni të ardhura të jashtëzakonshme si trashëgimi apo fitim në loto apo nëse pas shkëputjes nga ndihma sociale përsëri jetoni në kushte shumë të mira ekonomike

## **Çfarë të drejta keni ?**

### **Këshillime falas**

Shërbimi social ju këshillon falas. Ai ju ndihmon t'i shfrytëzoni të drejtat dhe kërkesat tuaja kundrejt organizatave zyrtare (shtetërore), institucioneve, punëdhënësve etj.

### **Besueshmëri absolute dhe respektim i të drejtave kushtetuese**

Shërbimi Social e bënë me ju një termin për një bisedë brenda një afati të dobishëm kohor dhe ndërmerr sqarimet e nevojshme. Të gjitha informacionet tuaja do të trajtohen rreptësisht në fshehtësi. Punëtorët/et social/e i nënshtrohen fshehtësisë zyrtare dhe nuk guxojnë të ndërhyjnë në të drejtat tuaja kushtetuese (si p.sh të drejtën e lirisë për vendosje).

### **Përgjigja me shkrim dhe e drejta për ankesë**

Nëse kërkesa e juaj me shkrim për përkrahje refuzohet, ju do të merrni një vendim me shkrim me udhëzimet juridike. Po qe se nuk pajtoheni me vendimin e Shërbimit Social, mund të kërkonit çdo kohë një vendim me të drejtën e ankesës.

## **Çfarë detyrimesh keni ju?**

**Vetiniativë dhe vetë-përgjegjësi** Ju detyroheni të bëni çdo gjë të mundshme që të përmirësoni situatën tuaj personale dhe financiare.

Re-integrimi në punë është një synim kryesor i mirëqenies sociale. Me këtë do të pengohet përjashtimi nga proceset e punës. Përkrahja për një rifillim dhe punësim, që të mundësohet siguri i ekzistencës – këto synime mund t'i arrijmë, vetëm nëse ju e sillni vetiniativën tuaj të nevojshme.

Ju jeni edhe më tutje përgjegjës për kryerjen e punëve tuaja personale. Ndhima e Shërbimit Social fillon atëherë, kur ju nuk mund t'i mbrojni më interesat ose kur nuk jeni më në gjendje t'i përmbushni detyrimet tuaja.

### **Ndershmëria, sinqeriteti dhe gatishmëria për bashkëpunim**

Shërbimi Social mund të punojë me ju suksesshëm, vetëm nëse ju menjëherë dhe me vërtetësi siguronit të gjitha informacionet e nevojshme për rrethanat tuaja personale dhe financiare. Nëse refuzoni të bashkëpunoni për sqarimin e nevojës tuaj për ndihmë, kërkesa e juaj nuk mund të trajtohet.

Nëse i fshihni faktet apo jepni informacione të rreme, që të merrni ndihmën sociale, do të përgjigjeni për vepër penale. Edhe pa ju urdhëruar, ju detyroheni ta informoni Shërbimin Social për të gjitha ndryshimet relevante. Përndryshe, ndihma e marr pa të drejtë duhet të kthehet prapa. Në rrethanat të pasqaruara mund të bëhen inspektime sociale. Veprimet e dënueshme gjithsesi do të denoncohen.

## **Ç' duhet bërë nëse ka problem me Shërbimin Social?**

---

Punëtorët/et social/e do t'ju parashtrojnë shumë pyetje personale, që të mund ta vlerësojnë dhe kuptojnë situatën tuaj si duhet. Ju i detyroheni këtyre sqarimeve. Nëse nuk pajtoheni me mënyrën e punës së punëtores sociale respektivisht të punëtorit social, mundohuni ta sqaroni këtë në një bisedë të drejtpërdrejt. Një bisedë e hapur ndihmon për të kapërcyer shumë vështirësi. Nëse kjo nuk është e mundur, mund të kërkonit një bisedë sqaruese te drejtorja e Shërbimit Social. Te Shërbimi Social nuk pranohet as dhuna psikike e as ajo verbale apo kërcënimet për dhunë. Në rastet e tilla do të informohet policia. Ju keni të drejtë të keni qasje në dosjen tuaj. Shfaqeni dëshirën për qasje në dosjen tuaj te punëtorja sociale respektivisht punëtori social

## **Kontakti**

---

Sozialdienst Stadt Bern  
Schwarztorstrasse 71, 3007 Bern  
Tel. 031 321 60 27  
Fax 031 321 72 54  
E-Mail: [sozialdienst@bern.ch](mailto:sozialdienst@bern.ch)  
[https://www.bern.ch/politik-und-verwaltung/  
stadtverwaltung/bss/sozialamt/sozialdienst](https://www.bern.ch/politik-und-verwaltung/stadtverwaltung/bss/sozialamt/sozialdienst)

## **Öffnungszeiten**

---

E hënë – e mërkurë	08.30 – 11.30 h 14.00 – 17.00 h
E enjte	14.00 – 17.00 h
E premte	08.30 – 11.30 h 14.00 – 16.00 h

Sporteli/Arka	
E hënë – e mërkurë dhe	
E premte	08.30 – 11.30 h

## **Orari i punës për regjistrime të reja.**

---

E hënë – e enjte	14.00 – 16.30 h
E premte	14.00 – 15.30 h